



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Komuna e Prishtinës, në bazë të Rregullores 01-020/01-194101/18, e dt. 08.08.2018 për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, hapë

THIRRJE PUBLIKE

Për të gjitha bizneset në Komunën e Prishtinës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Medias Elektronike të aplikojnë për mbështetje financiare.

1. Mediat në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me dokumentacion si më poshtë:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit,
- Të jenë të regjistruar ne Komunën e Prishtinës,
- Pasqyrat financiare,
- Vërtetimi i pagesës së kontributeve pensionale të punëtorëve,

2. Ndarja e subvencioneve bëhet në bazë të madhësisë së mediumit, numrit të punëtorëve të ndara në tri kategori

- Mbi 50 punëtor
- Mbi 8 punëtor
- Nën 8 punëtor

3. Vlera e përgjithshme e planifikuar është **100,000.00 (Euro)**.

Afati për dorëzimin e propozimeve është nga dt. **01.12.2020** deri më **08.12.2020, ora 16:00**.

4. Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve:

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë bizneset mediale elektronike që janë në territorin e komunës;
- Të kenë mbi 2 vjet përvojë punë profesionale.

5. Propozimet dhe dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në sportelet e pranimi të dokumenteve në objektin e Komunës së vjetër.

- Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin të kompletuar do të diskualifikohen. Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike. Dorëzimi i dokumentit të gabuar ose me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit.
- Do të konsiderohen për mbështetje financiare ato kërkesa që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: mediapr@rks-gov.net. Pyetjet mund të bëhen deri më dt. 10/12/2020.